

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION	
Njësia org. Org.Jedinica Org.Unit	01
Nr./ Faqja Br./Stranica No./Pages	1
Nr./ Prot. Broj Prot. Prot. No.	8746
Data: Datum: Date:	24.08.26
PRISHTINË/A	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporti
Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), bazuar në dispozitat e nenit 7 (paragrafi 2) të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër urban të udhëtarëve me autobus dhe nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë

VENDIM

I. Aprovohet, kërkesa nr.2531 date 20.02.2026 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "Driton Sedolli" B.I NTT"SEDOLLI" me seli në Suharekë për marrjen e nisjes në relacionin: Prizren Suharekë me orare të nisjes (12:50-13:40).

Arsyetim

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus "Driton Sedolli" B.I NTT"SEDOLLI" me seli në Suharekë, ka plotësuar kushtet ligjore për ndarjen e nisjeve të lira në relacionin e lartcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe

kushtet e shpalljes publike për marrjen e nisjeve ne relacionin: Prizren Suharekë me orare te nisjes (12:50-13:40).

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

Dimal Basha

Ministër



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.